# TOP PLUS 70 WP

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE

**"KLASA 2". Xn.**



**"I DEMSHEM"**



**N- I DEMSHEM PER MJEDISIN**

**Frazat e rrezikut:** R20, R43, R50, R53, R68. **Frazat e sigurisw:** S2, S36/37, S46, S60, S61.

**TOP PLUS 70 WP** eshte fungicid sistemik me veprim kurativ dhe parambrojtes me spekter te gjere veprimi per luftimin e semundjeve te ndryshme kepurdhore ne kulturat bujqesore. Merret si nga pjeset e gjelbera ashtu edhe nga sistemi rrenjor duke qarkulluar ne te gjithe bimen.

**Permbajtja:** *Thiophanate methyl 70%* **Formulimi:** *Pluhur i lagshem (WP)*

**Masat parambrojtese:**

- Mbajeni ne vende te sigurta dhe te paariteshme nga femijet;
- Ruajeni ne vende te thata dhe te fresketa, larg ushqimeve dhe pijeve per njerezit si dhe ushqimeve per blegtorine;
- Evitoni kontaktet e zgjatura te syve dhe lekures me preparatin;
- Evitoni marrjen e preparatit me organet e frymemarrjes gjate pregatitjes se solucionit sperkates dhe gjate sperkatjes;
- Gjate perdorimit te tij mos ha e mos pi uje dhe duhan;
- Gjate punes perdor paisje mbrojtese: kominoshe, doreza, maska, syze;
- Ne perfundim te punes lani duart dhe pjeset e ekspozuara te trupit si dhe paisjet mbrojtese, mjetet sperkatese;
- Asgjesimi i ambalazheve te behet sipas rregullave ne fuqi.

**Udhezime per ndihmen e pare dhe keshilla per mjekun:**

- Lani pjeset e kontaminimeve te lekures dhe membranat mukoze menjehere me uje te bollshem e sapun.
- Ne rast se eshte gelltitur preparati, provokoni te vjella.
- Mos i jepni te demtuarit substanca absorbuese si qumesht, vaj, alkool, etj. Jepni te demtuarit qymyr aktiv.
- Nxirreni te demtuarin ne ajer te paster, ne rast te fikti vendoseni ate ne nje pozicion anesor duke i dhene kokes pas, beni frymemarrje artificiale ne se nuk merr fryme.
- Ne rast helmimi, kerkoni menjehere ndihme ne qendren me te afert spitalore duke i treguar mjekut etiketen e ketij produkti.
- Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik.

**Perdorimi:**

***Ne domate, spec, patllixhan, tragull, etj.,*** per kontrollin e hireve *(Erysiphe spp.),* fuzariozave *(Fusarium spp),* kalbezimit gri *(Botrytis cinerea)*, verticiliozes *(Verticillium spp.)*, kalbezimit te bardhe *(Sclerotinia spp.)*, njollosjes se gjetheve *(Cladosporium spp.)* dhe antraknozave, me 100 gr/100 lit uje. Trajtimet fillojne me shfaqjen e simptomave te para.

***Ne Shalqin,*** kunder fusariozes ne farishte, me 85 gr/100 lit uje, duke perdorur 3-4 litra/$m^2$ solucion. Kunder fuzariozes ne fushe, me 85 gr/100 lit uje, duke trajtuar bimet individualisht me 200-300 gr solucion per rrenje, duke e persertur 3-4 here gjate vegjetacionit..

***Ne sallate laker e lulelaker,*** perdoret per kontrollin e fusariozes, hirit dhe kalbezimeve, me 80 gr/100 lit uje, me shfaqjen e simptomave te para.

***Ne fasule dhe bizele,*** per kontrollin e hirit *(Erysiphe polygoni),* sclerotinias *(Sclerotinia spp),* verticilliozes *(Verticillium spp.)* dhe antraknozes *(Colletotrichum spp.),* me 80 gr/100 lit uje, me shfaqjen e simptomave te para.

***Ne pemet frutore berthamore,*** per kontrollin e kalbezimit *(Sclerotinia laxa)*, duke perdorur 75 gr preparat/100 lit uje. Trajtimi i pare behet kur kane rene 75 % te petaleve. Per luftimin e hirit me 70gr//100 lit uje.

***Ne molle e dardhe,*** per kontrollin e kromave *(Venturia spp.)*, me 70 gr/100 lit uje, nga fillimi i çeljes se sythave vegjetative. Per luftimin e *Septoria spp.,* me 70 gr/100 lit uje, me çeljen e sythave lulore. Per kontrollin e hirit *(Podosphaera leucotricha)* perdoren 100 gr/100 lit uje, nga fillimi i çeljes se sythave vegjetative deri ne rritjen e plote te lastareve, çdo 10-14 dite.

***Ne hardhi,*** kunder kalbezimit gri *(Botrytis cinerea),* me 100 gr/100 lit uje, duke filluar nga lulezimi i plote deri 3-4 jave para vjeljes se prodhimit. Per kontrollin e hirit *(Uncinula necator)* perdoret me 100 gr/100 lit uje. Trajtimet fillojne qe nga dalja e 2-3 gjetheve, dhe perseriten ne vartesi te ecurise se infeksionit.

***Ne agrume,*** kunder kalbezimit, antraknozes *(Colletotrichum gloeosporoides),* me 100 gr/100 lit uje.

***Ne bime zbukuruese,*** kunder vrugjeve dhe semundjeve te tjera te gjetheve, hirit, kalbezimit te qafes e te rrenjeve, me 100-200 gr/100 lit uje.

***Per trajtimin e frutave pas vjeljes:*** Frutat pas vjeljes zhyten per 1-5 min. ne solucion 0.05-0.1 %.

**Verejtje per perdorimin:**

Perzihet me shumicen e fungicideve, insekticideve, akaricideve, rregullatoret e rritjes dhe ushqimeve gjethore. Nuk perzihet me lengun bordolez, sulfatin e bakrit dhe me produktet e tjera alkaline. Mos kryej me shume se dy trajtime gjethore per sezon.

**Fitotoxiciteti:**

Nuk eshte fitotoksik kur perdoret me dozat dhe ne kulturat e rekomanduara.

**Karenca**

Rrush per vere 35 dite. Kulturat e tjera 14 dite.

**Ndikimi ne ekosistem:**

Helmues per bletet. Njoftoni bleteritesit para se te kryen trajtimet. Helmues per peshqit. Mos ndotni ujrat dhe basenet ujore me produktin ose ambalazhin e tij.

**Magazinimi:**

Ruhet ne vende te errta, te fresketa dhe ne ambalazh origjinal.

Nr dhe data e regjistrimit: **599, datë 06.07.2015**;
Sasia neto: **25kg**
Data e prodhimit: **Janar 2018**
Periudha e ruajtjes: **3 vjet**;
Emri dhe adresa e fabrikuesit te PMB-se: **Zenith CropSciences Bulgaria. Asenovgradsko Shose, 4009 Plovdiv, Bulgaria.**
Emri dhe adresa e Aplikantit: **Zenith CropSciences Bulgaria. Asenovgradsko Shose, 4009 Plovdiv, Bulgaria.**